



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 31/2020 (JR)

Nr. 31/ regj.

Tiranë më 19.05.2022

SHPALLJE

E

NJOFTIMIT PËR ZHVILLIMIN E GJYKIMIT TË ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE

Nëpërmjet kësaj shpalljeje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar, se sot, më datë 19.05.2022, në seancën e thirrur në orën 10.00, pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, çështjen me numër regjistri (JR) 31/2020, datë 30.07.2020, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Adnand Xhelili kundër vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 237, datë 12.02.2020, vendosi shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, ditën **e mërkurë, në datën 08.06.2022, ora 10:00.**

Kolegji i Posaçëm i Apelit e mori këtë vendim bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në nenin 4, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 51, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, pasi vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 237, datë 12.02.2020 është bazuar në shkelje të rënda procedurale.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit” Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjyqësor, përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjyqësor
Relator i Çështjes
Gjyqtare
Gjyqtare
Gjyqtare

Ina Rama
Sokol Çomo
Albana Shtylla
Natasha Mulaj
Rezarta Schuetz

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile dhe në nenin 51, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, kjo shpallje bëhet



të paktën 10 ditë para seancës gjyqësore, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe atë të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE**


INA RAMA